

STATUTI

I

SHOQËRISË “PEOPLE CAPITAL FOUND” sh.p.k

Në Tiranë, sot më datë ___15.09.2021_____:

ERJONA SELIMI, lindur me 04/04/1985, ne Memaliaj , Shqiperi, identifikuar me karte identiteti me nr. 033491392, dhe me nr. personal I55404067P;

ERJON BINOZI lindur me 02/08/1986 ne Vlore, i/e identifikuar me karte identiteti me nr. 036776772, dhe nr. Personal I60802088H;

Në cilësinë e “ortakeve themelues“ kane rene dakort per hartimin e ketij akt themelimi , nëpëmjet të cilit deklarojne se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “**PEOPLE CAPITAL FOUND**” sh.p.k.

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria “**PEOPLE CAPITAL FOUND**” sh.p.k. është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar pranë QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**PEOPLE CAPITAL FOUND**” sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortakët e cila nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut te vetëm përben kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortakët gezojne kuotën e tyre në shoqëri në perpjestim me kuotën që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë ne Rruga Frederik Shiroka, kulla 2 , kati 1, nr. 16, Tirane.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nepermjet vendimit vetem nga Administratoret si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Kompania ka si objekt Shërbime konsulence në ndërtim, projekte studimore në fushën e ndërtimit. Projektim ndërtesash një dhe shumë katëshe. Supervizion i punimeve të ndërtimit. Kolaudim i punimeve të ndërtimit. Vlerësimi i pasurive të paluajtshme. Ekspertize në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Projekte energjitike, shërbime dhe konsulencë në fushën energjitike. Projektim të objekteve energjitike si hidrocentrale, termocentrale, central eolike, central fotovoltaike, central nga biomasa etj.

Shërbime dhe konsulencë në fushën e energjive të rinovueshme. Shërbime dhe konsulencë në fushën e efikasitetit të energjisë. Shërbime dhe konsulencë e performancës energjitike të ndërtesave. Shërbime dhe konsulencë në fushën e mjedisit. Shërbime dhe konsulencë në fushën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Shërbime dhe konsulencë në Vlerësimin e Impaktit Social (social impact). Import, export materialesh të ndryshme. Shërbim, konsulencë dhe vlerësim të aktiviteteve të industrisë ushqimore, kulinarise, përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore, blegtorale e industriale, aktivitete të hotelarisë dhe turizmit. Menaxhim dhe organizim eventesh, skena, foni, dekore të ndryshme, ndriçime skenike dhe publike, publicitete, spote televizive. Organizime mbi trashëgimitë kulturore, artistike, teatrale, spektakle brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria përmban ne objekt edhe veprimtarite si agjensi imobiliare.

Konsulencë manaxheriale; konsulencë shitjeje; konsulencë ekonomike dhe bankare; konsulencë për kredimarrje në sistemin bankar shqipëtar, hartim plani biznesi; studim tregu; konsulencë marketing dhe promovimi; konsulencë në burimet njerëzore; shërbime përfaqësimi ndaj shoqërive tregëtare, individëve, tregtarëve, qofshin këta vendas apo të huaj; konsulencë në fushën e telekomunikacioneve dhe teknologjive; konsulencë në fushën e energjive të rinovueshme, kryerjen e çdo aktiviteti dhe çdo veprimi në Shqipëri, ose jashtë territorit shqiptar, që kanë lidhje direkte ose indirekte me qëllimin e sipërpërmendur të shoqërisë ose që janë të nevojshëm për promovimin e aktivitetit dhe synimeve të shoqërisë.

Të procedojë në studime mjedisore, ekonomike, sociale apo ekonomike, dhe ekspozita të veçanta me nismën e saj, ose me delegimin nga Organizatat Nderkombëtare, institucione të cilat ndjekin të njëjtat qëllime ose qëllime korresponduese me qëllimin e kompanisë dhe janë subjekt i sektorit publik apo privat në Shqipëri ,vendet anëtare të Bashkimit Evropian apo vendeve të treta.

Të promovojë, krijojë, mbajë, menaxhojë nismat e Bashkimit Evropian dhe Organizatave të tjera Nderkombëtare dhe Kombëtare, apo programe të tjera në lidhje me zhvillimin rajonal dhe lokal dhe bashkëpunimin ndërkufitar, në Shqipëri, ne shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian ose në vende të tjera. Veçanërisht të kontribuojë në aktivitete që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri dhe vende të tjera, mbrojtjen e klimës reduktimin e ndotësve, kursimit të energjisë dhe mbrojtjen e burimeve minerare. Të kryejë studime afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e transportit, për strategjinë e zhvillimit të Ligjeve të Transportit në shkallë kombëtare, përcaktimin e teknologjive të reja dhe të sistemeve të avancuara të transportit, hartimin dhe përmirësimin e metodikave në lidhje me çështjet e operimit, ekonomike dhe të komercializimit, etj. për çdo lloj transporti, në përputhje me kërkesat e ekonomisë së tregut, zhvillimin e degëve të transportit lidhur me identifikimin e burimeve të finacimit, shpenzimet për investime kryesore, subvencione dhe shpenzime të tjera për sektorë të ndryshëm transporti, hartimin e kostos së operimit të llojeve të transportit, tendencat dhe planifikimin e trafikut në shkallë kombëtare dhe zonale, përcaktimin e rrjeteve të trafikut (korridoreve të transportit) në shkallë vendi, kualifikimin (trajnimin) dhe testimin e specialistëve në fushën e transportit,

hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit në fushën e transportit, hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit në fushën e transportit, orientuar nga direktivat e Bashkimit European, konventat dhe standartet ndërkombëtare në fushën e transportit.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal në (QKR) Regjistrin Tregtar, dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore të papercaktuar.

Kreu II

Kapitali

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali i shoqërisë është 50 000 leke. Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 2 (dy) kuota me vlerë, si me poshte:

ERJONA SELIMI, zoteruese e 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërisë me vlerë **25000** (njetzet e pese mije leke) qe perfaqeson 50% te kapitalit ;

ERJON BINOZI zoterues e 1 (nje) kuote te kapitalit te shoqerise me vlerë **25000** (njetzet e pese mije leke) qe perfaqeson 50 % te kapitalit ;

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të ortakëve duke kontribuar në natyrë ose në para dhe shërbime. Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit deri në vlerën minimale.

Kërkohe vendim i kualifikuar edhe kur zmadhimi i kapitalit ka si qëllim t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Me anë të një vendimit të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

Neni 8:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, duhet të përpilohet dhe firmoset kontratë me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, deri në çastin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Neni 9

Organi Vendimarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët i vetëm në rast se shoqëria është e themeluar nga një ortak i vetëm. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) të bleje, shese, kembeje pasuri të patundshme të shoqërisë;
- n) për shpërndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta. Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 10 Administrimi

Administratore e shoqërisë është **ERJONA SELIMI** e emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.
- f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në

përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblee së Përgjithshme të shoqërisë vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë së përgjithshme.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë asamblesë së përgjithshme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Dividenti

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, Asamblesë së shoqërisë.

Neni 17

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i

veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqërise.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare.

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me ketë statut dhe dispozitat e

legjislaconit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 3 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe, dhe pasi iu lexua ortakeve themeltare të shoqërisë, nënshkruhet me vullnetin e lirë prej tyre.

ORTAKET E SHOQERISE

ERJONA SELIMI

Erjona Selimi


ERJON BINOZI

Erjon Binozi
